



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 109, datë 09.07.2019

PËR

**SHPALLJEN E PROCEDURËS SË EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË, NGA
RADHËT E JURISTËVE TË SPIKATUR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

I. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.

II. Afati i kandidimit

1. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

III. Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit

1. Çdo jurist, që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, 2 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ftohet të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi të hapur publike dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin sipas pikës 6 të këtij Kreu.

2. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, janë si më poshtë:

- a) të ketë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;
- b) të mbajë gradë shkencore në drejtësi;
- c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit;

3. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara më sipër, duhet të plotësojë edhe kriteret, sipas nenit 48, pika 3, shkronja “c” dhe pika 5, si dhe nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - b) të jetë shtetas shqiptar;
 - c) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë;
 - ç) të mos jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - d) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;
 - dh) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete,
 - e) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas ligjit.
4. Plotësimi i kushteve dhe kriterëve të mësipërme verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës se përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.
5. Kandidati që përmbush kushtet dhe kriteret e parashikuara në pikat 2 dhe 3 më sipër, vlerësohet, pikëzohet dhe renditet sipas kërkesave dhe procedurës se përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.
6. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :
- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë, sipas kërkesave të shpallura;
 - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
 - c) Fotokopje të kartës së identitetit;
 - d) Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushja e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Kreu.

IV. Vendi i dorëzimit të dokumentacionit

1. Dokumentacioni i kandidatëve sipas pikës 6 të Kreut III, duhet të dorëzohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR